



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12/12/2019

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.12.2019, të parashtruar nga **Grupi i Operatorëve Ekonomik NSHT "Viktory Com & Company Murseli shpk & Grand Construction shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja e autorrugëve" – pj.I-rë: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane"**, me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211.

nxjerr:

V E N D I M

- II. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi i Operatorëve Ekonomik NSHT "Viktory Com & Company Murseli shpk & Grand Construction shpk, të dt. 10.12.2019, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Mirëmbajtja e autorrugëve" – pj.I-rë: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane"**, me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211, kundër Njoftimit MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 05.12.2019, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 05.12.2019;

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të ju dorëzohet palëve/

Arsyetim

I. Grupi i Operatorëve Ekonomik NSHT "Viktory Com & Company Murseli shpk & Grand Construction shpk, me datë 10.12.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Mirëmbajtja e autorrugëve** – **pj.I-rë: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane"**, me Nr. **632-19-7809-2-1-1**, Nr. Brendshëm **632-18-072-211**.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.12.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, Autoriteti Kontraktues, konstaton se **Grupi i Operatorëve Ekonomik Sh. "Drini Company" sh.p.k & "Berisha Com" sh.p.k.** i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është eliminuar, për arsye se nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues, të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivitet të Komunës

Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

